

**AKTI I THEMELIMIT I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Starnova” shpk**

Sot, Më datë 01/10/2022, shoqëria krijohet nga unë ortaku themelues:

**Znj. Enxhi Neli**, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J35915067P, e datëlindjes 15/09/1933, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 1:  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “**Starnova**” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislatacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaike), energjisë së erës (eolike) dhe energjisë gjeotermale në Republikën e Shqipërisë dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministri e Institucioneve të shtetit shqiptar i të gjitha miratimeve, lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyj aktiviteti në mënyre të qetë dhe në perputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë si dhe shërbime të tjera të ngjashme ose të lidhura me sa me sipër të cilat nuk ndalohen me ligj në Shqipëri dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme.

- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Myrteza Kellici , pallati AL-FAM, katë i dytë, Nr.hyrje D.22, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Faqe 1 e 2  
Akti i Themelimit  
“Starnova” shpk



**Neni 5:  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Znj.Enxhi Neli: Zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 lekë që përben 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:  
Administratori**

- 1) Administratore e shoqërisë emërohet Znj.Enxhi Neli, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J35915067P, i datëlindjes 15/09/1993, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar. me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 7:  
Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e tij ne përputhje te plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8:  
Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Starnova” shpk**

**Enxhi Neli**  
(Emër, Mbiemër, Firma)

  
*Enxhi Neli* .  
Faqe 2 e 2  
Akti i Themelimit  
“Starnova” shpk